

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/06/21;
Datë: 21.06.2021 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Muharrem Krasniqi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: mbledhja e gjashtë-(2021) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 28.06.2021, ora 14⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i KAB-it komunal 2022-2024;
3. Shqyrtimi për instruksionin e rishikimit të Buxhetit për vitin 2021 ;
4. Kërkesë për ndarjen e çmimit „ Kuvendi i Junikut” për martirët dhe dëshmorët të rënë për Liri, në mbrojtje të Junikut dhe Atdheut ;
5. Kërkesë për anulimin e Vendimit Nr. 02/11/2021, për faljen e borxheve për vitin 2021 për të gjitha bizneset të cilat paguajn borxhet paraprake, i miratuar me datë 30.04.2021:
6. Të ndryshme



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-05/21
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	28.05.2021
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së pestë (5) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2021 me datë: 28.05.2021, në ora 14:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Muharrem Krasniqi, i cili në fillim përshëndeti përfaqësuesit e Kfor-it, Hoxhen e Xhamisë së Qendrës: Mulla Esat Qestaj, Anëtarët e Kuvendit Komunal, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit.

Mbledhja u organizua duke respektuar udhëzimet e IKSHPK-së.

Anëtarët prezent

1. Muharrem Krasniqi - Kryesues, AAK
2. Behare Qestaj - Anëtare, AAK
3. Sindije Idrizi - Anëtare, AAK
4. Betim Gacaferi - Anëtar, AAK
5. Albert Gjocaj - Anëtar, AAK
6. Xhemë Tofaj - Anëtar, AAK
7. Dardane Shala - Anëtare, AAK
8. Tahir Isufaj - Anëtar, LDK
9. Blerim Gacaferi - Anëtar, PDK
10. Edona Shehu - Anëtare, LDK

11. Zenel Maloku - Anëtar, i pavarur
12. Gjyle Miroci - Anëtare, LVV
13. Zeqë Hebibi - Anëtar, LDK

Munguan: Florim Shala - Anëtar, LVV
Erleta Isufaj - Anëtare, LDK

z. Muharrem Krasniqi: Florim Shala ka lajmëruar që nuk do të marrë pjesë në këtë mbledhje, Betim Gacaferi është duke ardhur kurse për Erleta Isufaj nuk kam informacion. Pra, nga 15 anëtarë jemi 12 prezent. Pastaj propozojë këtë rend të ditës.

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Formimi i grupit punues për hartimin e Projekt - Planit të punës së Kuvendit Komunal të Komunës së Junikut për vitin 2022,
3. Raporti Financiar Janar - Mars 2021,
4. Propozim - vendim për hartimin e Programit trevjeçar Komunal për banim 2021 - 2023,
5. Miratimi i draft - Rregullores për menaxhimin e varrezave Komunale,
6. Propozim - vendimi për plotësim - ndryshimin e Rregullores për: Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Mirënjohjet dhe Falenderimet në Komunën e Junikut,
7. Të ndryshme.

z. Muharrem Krasniqi: E hapi debatin sa i përket këtij rendi të ditës. Fjala për përfaqësuesen e AKK - PDK-së.

znj. Behare Qestaj: Përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe u pajtuan me këto pika të rendit të ditës.

z. Muharrem Krasniqi: E falenderoj znj. Behare Qestaj dhe tutje i dha fjalën z. Tahir Isufaj në emër të LDK-së.

z. Tahir Isufaj: Nuk shtojë asgjë.

z. Muharrem Krasniqi: Tutje e hedhi në votim këtë rend të ditës. Nga 12 prezent, 12 ishin për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e parë e rendit të ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z. Muharrem Krasniqi: Pyeti nëse dikush nga anëtarët e Kuvendit Komunal kanë ndonjë vërejtje rreth procesverbalit.

z. Sindije Idrizi: Fillimisht përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe tha se procesverbali nuk i kishte ardhur.

z. Muharrem Krasniqi: Sigurisht ka qenë gabim teknik dhe i dha të drejtën që në mbledhjen e ardhshme të jep vërejtje nëse ka për këtë procesverbal pa kaluar në procesverbalin e muajit tjetër. Kryesuesi e hedhi në votim këtë procesverbal dhe nga 12 anëtarë prezent, 11 ishin për, kundër asnjë, 1 abstenim, kalon.

Pika e dytë e rendit të ditës

2. Formimi i grupit punues për hartimin e Projekt - Planit të punës së Kuvendit Komunal të Komunës së Junikut për vitin 2022.

z. Muharrem Krasniqi: Koleg të nderuar siç e dini, ne çdo vit e bëjmë Planin Komunal për vitin pasardhës, ku dy anëtarë janë nga Kuvendi, unc jam anëtar i tretë si Kryesues i Kuvendit, një nga Shoqëria Civile dhe një nga ekzekutivi. Dhe kërkoj që ti jepnin emrat e grupit punues për hartimin e këtij plani.

znj. Behare Qestaj: Nga AAK-PDK, e propozuan z. Blerim Gacaferi.

z. Tahir Isufaj: Nga LDK-VV, e propozuan z. Zeqë Hebibi.

z. Hasan Krasniqi: Nga ekzekutivi e propozuan znj. Kosovare Gacaferi Hadergjonaj.

z. Muharrem Krasniqi: Pyeti a ka ndokush ndonjë propozim nga Shoqëria Civile.

z. Hasan Krasniqi: Nga Shoqëria Civile e propozuan znj. Safete Shehu.

z. Muharrem Krasniqi: Pra, grupi punues për hartimin e Projekt Planit të punës së Kuvendit Komunal të Komunës së Junikut për vitin 2022 përbëhet nga: Muharrem Krasniqi, Blerim Gacaferi, Zeqë Hebibi, Kosovare Gacaferi Hadergjonaj dhe Safete Shehu. E hedhi në votim, nga 12 prezent, 12 për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon.

Pika e tretë e rendit të ditës

3. Raporti Financiar Janar - Mars 2021.

z. Muharrem Krasniqi: I dha fjalën Drejtoreshës për Buxhet dhe Financa, znj. Kosovare Gacaferi Hadergjonaj.

znj. Kosovare Gacaferi Hadergjonaj: E prezantoi Raportin Financiar Janar - Mars 2021 për Komunën e Junikut.

z. Muharrem Krasniqi: Para se t'iu jepte fjalën për diskutim, tregoj se tani janë prezent në sallë 13 anëtarë, pra tani është dhe Betim Gacaferi.

znj. Behare Qestaj: Në emër të grupit nuk kishin diçka të shtonin.

z. Tahir Isufaj: Të lirë janë. Nuk kemi diçka.

z. Muharrem Krasniqi: Atëherë, kush e dëshiron fjalën sa i përket Raportit Financiar tremujor.

z. Tahir Isufaj: Jam i interesuar tek investimet kapitale, ku kanë shkuar.

znj. Kosovare Gacaferi Hadergjonaj: Tek tabela e investimeve kapitale në faqe 14, prej alokimeve 31,754.35 €, janë shpenzimet aktuale për këtë periudhë 15,000.00 €, ku 10,000.00 € janë në projektin Rehabilitimi i Rrugëve Lokale dhe 5,000.00 € janë për projektin Hapja e Rrugëve Fushore.

z. Tahir Isufaj: Cilat janë rrugët lokale dhe cilat fushore, qenka këtu edhe Drejtori.

z. Hasan Krasniqi: Është mirëmbajtja e rrugëve lokale se kjo është për këtë pozitë. Kryesues nëse bën me ia leju fjalën Menaxherit të projektit sepse ka informata me të detajshme.

z. Shpejtim Kuçi: Përsëritet për të gjithë, titulli Rehabilitimi i Rrugëve Lokale nuk do të thotë veç rehabilitimi i rrugëve, aty brenda kontratës janë edhe disa pozicione të tjera, për shembull: vërshimet që kanë ndodhë në Komunën e Junikut, kemi pasur vendosjen e gypave në disa lagje, i kemi rrugët tek varreza gjithë ato janë rehabilitu, besoj që i keni parë.

z. Tahir Isufaj: Nuk i kemi parë asnjë, ti nuk po i përmend a ka kanalizime, a ka përcjellje të ujësllësit, ju e keni shkruajtur këtu vetëm rrugë lokale.

z. Hasan Krasniqi: Projekti Rehabilitimi i Rrugëve Lokale e kemi si tip mirëmbajtje të rrugëve lokale, me këtë nënkuptojmë mirëmbajtjen e rrugëve poshtë, në zonën urbane të rrugëve të Junikut por njëkohësisht dhe mirëmbajtjen e rrugëve në pjesën e Bjeshkës, do të thotë çdo vit e kemi mirëmbajtje në segmente të caktuara edhe pjesë të rrugëve të Bjeshkës. Siç e dim këtë vit me rastin e vërshimeve, kemi pasur dëme shumë të mëdhaja, kemi pasur dëmtime të rrugëve, pjesën e rrugëve Gjocaj dhe Jasiq, pjesën që është intervenu tek Dema, kemi pasur në Qestaj dhe une iu kisha falenderu operatorit ekonomik që ka qenë shumë bashkëpunues në ato momente të këqija të motit kanë ardhur me eskavator, makineri dhe kanë punuar, ia kemi arritë sa kemi mujt me i mbajtur rrugët të qarkullueshme, kostoja bile ka qenë më e madhe se ajo që e kemi pasur në kontratë, kemi pasur shpenzime të jashtëzakonshme.

z. Muharrem Krasniqi: Faleminderit Drejtor, fjala për ju Zeqë.

z. Zeqë Hebibi: Po më intereson ku është kjo rruga fushore, ku është hapur dhe asfaltimi i rrugës lokale që janë 20,000.00 € dhe 10,000.00 €.

z. Leonard Lllolluni: Përsëritet për të gjithë të pranishmit, ne si Drejtori dy vite rresht kemi implementu projektin “ Hapja e Rrugëve Fushore ” me qëllim për me kriju kushte më të mira edhe për fermeret që e shfrytëzojnë sezonin veror edhe në Bjeshkë. Në këtë rast rrugët që i kemi hapur në territorin e Komunës së Junikut janë: rruga tek prita e katundit, rruga në Lagjen Qestaj, rruga tek Teqja e madhe që vazhdon dhe lidhet me Pepsh, rruga e tjetër tek livadhi i verrave që shkon deri tek gështënjat e Gacaferit, e kemi hapur edhe një pjesë të rrugës në Bjeshkë, në Pllaqicë të Junikut.

z. Zeqë Hebibi: Nuk keni hapë asgjë në Gacafer.

z. Tahir Isufaj: Me çfarë buxheti është kjo, gjithë këto hapje. Ku e keni atë buxhet.

z. Leonard Lllolluni: Kjo 5,000.00 € që e kemi paguar këtë vit është obligim i vitit të kaluar, ne kemi participu si Komunë sepse projekti ka qenë donacion nga Ministria e Zhvillimit Rajonal. Gjithë këto rrugë mund të dalim dhe t'i shohim.

z. Zeqë Hebibi: Kjo rruga në Gacafer që po thu ti tek livadhi i verrave, u ndalë rruga në gjysmë se i keni hyrë njeriut nëpër tokë, a është kështu? Dhe kjo Asfaltimi i Rrugëve Lokale 20,000.00 € po më intereson ku i keni bërë.

znj. Kosovare Gacaferi Hadergjonaj: Asfaltimi i rrugëve Lokale është vetëm alokim nuk është shpenzim.

z. Muharrem Krasniqi: Nëse nuk e dëshiron dikush tjetër fjalën, atëherë kjo pikë nuk votohet.

Pika e katërt e rendit të ditës

4. Propozim - vendim për hartimin e Programit trevjeçar Komunal për banim 2021-2023.

z. Muharrem Krasniqi: Nga Drejtoria e Urbanizmit kemi marrur një kërkesë për ta formuar edhe një komision për t'i filluar procedurat për hartimin e programit trevjeçar Komunal për banim, ekzekutivi i ka sjellë edhe emrat e anëtarëve, kurse emrat e anëtarëve tjerë i caktojmë na, por njëherë të na njofton Drejtori për çka është fjala.

z. Hasan Krasniqi: Në bazë të obligimeve që dalin nga ligji 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, Komuna ka obligim ta hartojë programin trevjeçar të banimit, ne e kemi drejtu një kërkesë për me nxjerr vendimin që të vazhdojmë me procedurën, kemi kërkuar njëkohësisht me hartu edhe grupin punues i cili ka për të punuar, kemi propozuar një grup punues pak sa me të gjerë që përfaqëson edhe ekzekutivi, në mënyrë që ti përfshijmë të gjitha lomitë që involvohen në programin e banimit. Kishim kërkuar nga ju që sa anëtar që e sheh Kuvendi të arsyeshëm të jenë anëtarë të grupit punues. Ju faleminderit për mbështetjen.

z. Tahir Isufaj: Kjo kërkesë a bën të ndryshojë ndonjë gjë, Kuvendi me propozu ndonjë zgjedhje tjetër.

z. Hasan Krasniqi: Gjithësesi, por këtu është fjala për një grup punues i cili do të jep kontribut në secilën pikë të veçantë, për këtë arsye thash edhe prej Kuvendit vetëm me fillu procedurat, pra grupit punues me iu hartu programi pastaj e diskutojmë a na pelqen apo jo.

z. Tahir Isufaj: Jemi duke shkuar në rrugë të gabueshme, më mirë me u ndalë pak më herët. Shikoni, ndyshon banimi në Junik me banim në Pejë ose me banim në Prishtinë.

z. Muharrem Krasniqi: Atë nuk e kemi vendos ne çfarë banimi ende, ne veç po e bëjmë me e formu rregulloren, në rregullore e caktojmë ne çfarë banimi e bëjmë.

z. Zeqë Hebibi: Nëse bëhet ky vendim, a ka paraparë rregullorja parcellë ku me u nda.

z. Hasan Krasniqi: Nuk diskutohet në këtë fazë as ndërtimi i objekteve as a do të ketë parcellë, do të bëhet një program i banimit, grupi punues ka për detyrë me i drejtu nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, mundësitë e Komunës dhe eventualisht edhe donatorët.

z. Muharrem Krasniqi: Tutje i lexoj emrat e anëtarëve të Ekzekutivit që do të jenë pjesë e grupit punues të cilët janë: Hasan Krasniqi, Leonita Jasiqi, Myrtë Velijaj, Demë Ukaj, Avdyl Maloku dhe Xhevahire Krasniqi. Kurse ne sa dëshirojmë ti dërgojmë.

z. Tahir Isufaj: Pyeti se përse 6 anëtarë nga ekzekutivi.

z. Muharrem Krasniqi: Vëllimi i punëve është i madh për këtë arsye.

znj. Behare Qestaj: Propozoj që nga secili grup me qenë nga 1.

z. Muharrem Krasniqi: U vendos që të dërgohen 3 anëtarë nga Kuvendi dhe i kërkoj emrat e tyre.

Anëtarët që u propozuan ishin: nga AAK Albert Gjocaj, nga LDK Zeqë Hebibi, nga LVV Florim Shala. Pra, grupi punues për hartimin e kësaj rregullore përbëhet nga: Hasan Krasniqi, Leonita Jasiqi, Myrtë Velijaj, Demë Ukaj, Avdyl Maloku, Xhevahire Krasniqi, Albert Gjocaj, Zeqë Hebibi dhe Florim Shala. E

hedhi në votim, nga 13 prezent, 13 për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon. Pra, dhe si pikë e rendit të ditës, kalon.

Pika e pestë e rendit të ditës

5. Miratimi i draft - rregullores për menaxhimin e varrezave komunale.

z. Muharrem Krasniqi: Shtojë se kjo si pikë ka qenë e inicuar vitin e kaluar, është formuar dhe grupi punues dhe për punën e atij grupi punues çka kanë arritë në përfundim ia kaloj fjalën Drejtoreshës Leonita Jasiqi.

znj. Leonita Jasiqi: Përshëndeti Kryesuesin, Drejtorët, Anëtarët e Kuvendit dhe gjithë të pranishmit. Pas marrjes së vendimit nga ana e juaj, Kryetari i Komunës ka formuar grupin punues të përbërë nga: Leonita Jasiqi-Kryesuese, Hasan Krasniqi-Anëtar, Behare Qestaj-Anëtare, Shpejtim Kuçi-Anëtar, Afrim Hoxha-Anëtar. Grupi punues është takuar disa herë dhe ka hartuar një rregullore, gjithashtu ky grup e ka parë të domosdoshme që pjesë e këtij grupi të jenë dhe imami i xhamisë së Qokut z. Imer Krasniqi, i xhamisë së Qendrës z. Esat Qestaj dhe dervishi i Teqes së madhe z. Avni Muslijaj. Do të thotë kjo kërkesë nga grupi punues i është drejtuar Kryetarit i cili e ka marrë sërish një vendim që si pjesë e grupit punues të jenë edhe dy imamet e Junikut dhe dervishi i Teqes së madhe. Pas kësaj grupi punues është takuar sërish dhe ka hartuar rregulloren të cilën e keni ju. Rregullorja i ka 7 kapituj dhe 31 nene dhe si e tillë përcakton qartë kushtet të përgjithshme për varreza, ofrimet e shërbimeve të varrimeve, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave. Meqenëse edhe Drejtori Hasan Krasniqi ka qenë pjesë e grupit punues fjalën ia kisha kaluar Drejtorit.

z. Hasan Krasniqi: Kemi debatuar shume me grupin punues dhe në shumicën e pikave kemi pasur unitet, kemi marrur për obligim me i tregu ato pika që nuk kemi pasur unitetin e grupit do të thotë i kemi pasur disa propozime prej imameve të xhamive që nuk kemi mundur si grup t'i kalojmë, kanë qenë tri: është kërku që varrezat të jenë të gjitha të njëjta, të mos punohen me beton dhe lule plastike mos me sjellë në varreza. Ne me keqardhje nuk kemi mundur që ti kalojmë këto pika, është vendos në bazë të votave në atë rast.

z. Muharrem Krasniqi: Une iu njoftoj se kjo rregullore do të kaloj në diskutim publik pastaj do të jetë edhe një herë në Kuvend.

z. Tahir Isufaj: Kush është hartues i kësaj rregullore.

z. Muharrem Krasniqi: Grupi punues.

z. Tahir Isufaj: Dikush është marrë me të, se une shikova gati gjysma e Komunave i kanë të njëjta. Juniku i ka specifikat e veta.

znj. Leonita Jasiqi: Normalisht, Asociacioni i Komunave, Ministrinë e Linjës janë rregulloret për të gjitha Komunat dhe secila Komuna i përshtat për nevojat e veta. Besoj dhe mendoj që iu janë përshtatur specifikave e Komunës së Junikut.

z. Tahir Isufaj: Kjo duhet 50% me ndryshu. I kanë bërë copy-paste.

z. Hasan Krasniqi: Shumica e tyre është e kopjuar prej një Draft rregullore që është për Nivelin Qendror, është shumë më e vogël se Komunitet e tjera që e kanë, për shkak të specifikave që i ka vet Komunitet.

z. Tahir Isufaj: Nuk e di a keni bisedu, se ju e dini që në Junik gati gjysma e territorit është me varreza.

z. Hasan Krasniqi: Ne e kemi çekur që kemi varreza formale dhe joformale. Joformale janë gjitha ato varreza që nuk janë me vendim të Kuvendit.

z. Tahir Isufaj: Me vendim janë vetëm në një vend. Në Rugopëq dhe atje nuk jemi duke e shfrytëzuar.

z. Muharrem Krasniqi: Pastaj ju dha fjalën në emër të grupeve.

znj. Behare Qestaj: Grupi nuk pajtohet.

znj. Sindije Idrizi: Nga aspekti fetar si e lejon feja ne mund ta bëjmë të gjithë, për shembull une kisha dashtë pa beton, pa lule ashtu në bazë të fesë, por duke u bazuar se nuk është besimi i njëjtë i gjithë qytetarëve, ka me pasë kundërshtime të shumta dhe në qoftë se ne e miratojmë do kemi kundërshtime prej qytetarëve, reagime të tjera kur del kjo në publik, mirpo këtu ne nuk po mundemi me marrë një vendim të saktë se cila është më e mira dhe me i bë gjitha njëjtë.

z. Muharrem Krasniqi: Sindije, grupi e ka pasur vetëm si dilemë se nuk është në rregullore.

znj. Sindije Idrizi: Po kuptoj une, por edhe për ne është e vështirë me vendos se cila është më e mirë. Une thash, nëse me pyet mu, une e kisha bërë në bazë të fesë. Por nuk mundem, për shembull me i bindë prindërit e mi, se ndoshta as ata nuk pajtohen me mendimin tim.

z. Zenel Maloku: Kam ndëgjuar se çdo delegacion i çdo shteti në botë kur vjen në një shtet së pari shkon dhe i shikon varrezat, aty e sheh kulturën e atij shteti dhe i sheh rregullat e atij shteti. Une nuk jam për me ia vendos një guri tek koka, tek kembet, pa asgjë, hidhja 5 kolica, ka thënë Hoxha. Hoxha prindin e vet e shtin në dhe me arkivol, e ajo është jashtë islamit. Islami nuk e parasheh me hy me arkivol në dhe. Une po them si është më së miri për shtet, lerëni punën e hoxhve.

znj. Leonita Jasiqi: Kërkoj të jep sqarim dhe sqaroj rreth asaj sërisht se pjesë e grupit punues kemi qenë 9 anëtar, prej tyre 7 jemi pajtuar për rregulloren që e keni para, nuk do të thotë që edhe Hoxhët ndoshta nuk janë dakordu, nuk janë dakordu në ato tri pika sepse ata e kanë konsideruar se në bazë të fesë duhet të jetë ashtu. Pra, ata nuk e kanë penguar procesin e hartimit të rregullores që të shkoj tutje.

z. Muharrem Krasniqi: Sqaroj gjithashtu se këto janë vetem pretendime të Hoxhallarëve, nuk i keni në rregullore. Në rregullore do të thotë i keni me i bo si të doni varrezat. Mirë, fjala për z. Zeqë Hebibi.

z. Zeqë Hebibi: A bën dhe dy anëtar të Kuvendit të shkojnë në këtë grup punues, ne me u konsultu me njëri tjetrin ose me lënë për mbledhjen e ardhshme ose me na jep 15 minuta pauzë dhe të shikojmë se çka po dëshirojmë të bëjmë.

z. Muharrem Krasniqi: Kjo është në fazën e parë, pra ka me dalë në ndëgjim publik dhe ka me ardhë përsëri në Kuvend, ju jeni të lirë të jepni propozime, të shtoni, të hiqni, pastaj ne e votojmë vet. Gjithashtu edhe qytetarët kanë mundësi me shtu ose me heqë, ne rregulloren kur e kalojmë herën e dytë kjo bëhet dhe e dërgojmë në Prishtinë, nëse e miraton Prishtina pastaj kjo rregullore hyn në fuqi.

znj. Dardane Shala: Pse nuk po e cekni që ka me dal në ndëgjim publik, pastaj ne kemi për ta pasur më të lehtë që të vendosim kur edhe qytetarët e japin sugjerimin e tyre dhe e votojmë.

znj. Leonita Jasiqi: Sic janë rregullat e rregullores, grupi punues del nga Kuvendi ju e dini. Grupi punues e harton rregulloren dhe anëtarët e grupit punues në fazën e hartimit nuk e kanë për obligim me diskutu me secilin dhe pas hartimit rregullorja sjellet në Kuvend dhe në këtë fazë ju keni të drejtën e diskutimit, nëse ju e miratoni me leximin e parë pastaj rregullorja del në ndëgjim publik, aty mund të jetë secili prej jush me jep mendimet e tyre. Në qoftë se grupi punues e sheh që janë të arsyeshme atëherë mund të jenë në rregullore dhe e sjellin në lexim të dytë.

znj. Sindije Idriqi: Drejtoreshë, sa i përket mirëmbajtjes së varrezave kush i mirëmban ato varreza, sepse nuk keni cekë diçka më në detaje.

znj. Leonita Jasiqi: Sipas nenit 13, faqja 6, Organi kompetent për mirëmbajtjen e varrezave është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Inspektion.

z. Muharrem Krasniqi: E hedhi në votim këtë pikë, ku nga 13 anëtarë prezent, për ish-in 9, kundër 4, asnjë abstenim, kalon

Pika e gjashtë e rendit të ditës

6. Propozim - vendimi për plotësim - ndryshimin e rregullores për: Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Mirënjohjet dhe Falenderimet në Komunën e Junikut.

z. Muharrem Krasniqi: Fjala për ju Drejtoreshë.

znj. Kosovare Gacaferi Hadergjonaq: Meqenëse kryesuesja e grupit nuk ka mundur të merr pjesë, me ka adresuar mua të ia mbrojë pikën. Kjo projekt rregullore do të mbetet e njëjtë përpos që kanë ardh me një propozim që të shtohen në nenin 3, pikat 3.4.5, titulli: Martirët e Junikut dhe kësaj rregullore i është shtuar edhe neni 8, titulli: Martirët e Junikut, që do të sqarohet më tutje se çka do të përmbajë ky titull, është po aq e nevojshme me qenë edhe kjo pjesë e kësaj rregullore, sepse i ka munguar dhe e kemi propozu që të plotësohet me këtë titull, nëse edhe ju pajtoheni.

z. Muharrem Krasniqi: Tutje e lexoj nenin 8.

z. Tahir Isufaj: E dha një propozim të hapet një fabrikë që të bëhen dekoratat.

z. Muharrem Krasniqi: Dikush që e sheh të arsyeshme, mund ta hapë. Dhe e hedhi në votim këtë pikë, ku nga 13 prezent, 12 ish-in për, kundër nuk ka, abstenim 1, kalon.

Pika e shtatë e rendit të ditës

7. Të ndryshme.

z. Tahir Isufaj: Kishte dy vërejtje, e para ishte: ekzekutivi këtu është i rregullt, por edhe Kryetari e ka një përqindje jashtëzakonisht të vogël në këto mbledhje, ndërsa vërejtja e dytë ishte: që është mbajtur Kuvendi i Junikut që e keni manifestuar atë ditë që është 109 vjetori, të paktën ta kishit lënë deri 110, çdo 10 vjet. Për çka e festuat. Fushatë elektorale është bërë, covidin nuk e keni respektu, vetëm 5-6 persona kanë dalë të nësërmën. Gjithë ata njerëz në një hapësirë të vogël.

z. Muharrem Krasniqi: Mua më kanë thënë me i njoftu anëtarët e Kuvendit së ka qenë me protokol puna të dihet ku kanë me u ulë puna anticovid-it, me e ruajt distancën, u marrë salla e madhe për këtë arsye nuk u mbajtë në këtë sallë, për shkak të hapësirës është mbajtë në sallën e madhe tek Oda e Junikut. Une nuk kam mundur të marrë pjesë për probleme shëndetësore, nuk e di si ka qenë por na njofton tani Drejtori Hasan Krasniqi.

z. Hasan Krasniqi: Kjo ka ardhur si në kuadër të një karvani të Institutit të Historisë Shqiptare të Shkupit dhe nipashit të Hasan Prishtinës që kanë filluar për 109 vjetorin e punës së madhe që është bërë në Kuvendin e Junikut, e falenderojmë Presidenten dhe Zëvendëskryeministrin, përfaqësuesit e shtetit që kanë qenë, kemi marrur dhe lavdata për punën e mirë, falenderoj qytetarët e Junikut që kanë qenë shumë të kujdesshëm, masat kanë qenë në nivel anticovid dhe salla ka qenë e madhe, kemi qenë shumë këmbëngulës me i mbajtë maskat.

z. Zeqë Hebibi: Mua po më intereson komisioni për pandemi sa kanë ecë, a i kanë dhënë mjete dikujt deri më sot dhe pse ata që i kanë bërë analizat në privat nuk kanë të drejtën me përfitu.

z. Muharrem Krasniqi: Komisioni e ka kryer punën, na e kemi nxjerrë vendimin, Prishtina e ka kthyer vendimin që nuk ka nevojë për Prishtinë, dhe së është në rregull sa na përket neve, tash a kanë formuar komision tjetër që është dashtë me formu Kryetari, sa persona kanë apliku, për këtë nuk jam në dijeni por mund ta kërkojmë prej Drejtorit të Shëndetësisë të na sjellë raportin për mbledhjen e ardhshme.

z. Zeqë Hebibi: Komisioni u formu për me i kualifiku njerëzit.

z. Muharrem Krasniqi: Komisioni e ka bërë vetëm vendimin pra vendimin e kemi bërë tash formohet komisioni që i kualifikon njerëzit.

z. Zeqë Hebibi: A është bërë apo po presin deri në kohën e zgjedhjeve dikur me shku dhe me iu thënë njerëzve ja 100 euro qitma votën jo për pandemi. Kjo nuk është e drejtë dhe pse nuk kanë të drejtë me përfitu ata që i kanë bërë në privat, ku realisht ata që i kanë bërë në të shtetit e kanë pasur më të lehtë sepse nuk kanë paguar.

znj. Leonita Jasiqi: Sa une jam në dijeni ju e keni marrë një vendim do të thotë siç e ceket ju, Komuna e ka qitë njoftimin që qytetarët janë në fazën e kompletimit të dokumentacionit janë duke apliku, ju e dini që disa ditë gjatë muajit Maj ka qenë pushim dhe për shkak të pandemisë, në momentin që konsiderojmë që kanë aplikuar të gjithë pastaj mbyllet ajo, diskutojnë komisioni dhe pastaj dalin mjetet. Sa i përket asaj a është Institucion Privat apo Shtetëror nuk e kemi marrë ne, është vendim i Republikës së Kosovës.

z. Zenel Maloku: Komisioni e ka kryer punën e vet atë që i ka taku, komisioni ka thënë si kërkesë me iu dhënë nga 100 € për kokë banori i cili ka qenë i infektuar me covid, aty ka qenë edhe Drejtori i Shëndetësisë Ali Kuçi, kanë sjellë vendim personat që kanë vdekuar nga covidi në Junik pra banorë të Junikut me iu dhënë nga 400 € për kokë banori dhe është në pyetje personat që pranohen ose nuk pranohen, ku ka ardhur vendimi se vetëm ata persona që janë të testuar prej IKSHPK-së dhe të tjerët nuk mund të përfitojnë, dhe nëse pyet pse ka qenë se nuk ka dalë real testi që është bërë në privat, kur kemi qenë ne në komision kanë qenë 70 persona të testuar nga IKSHPK-ja.

z. Zeqë Hebibi: Pyeti a është formuar komisioni për Kodin Etik.

z. Muharrem Krasniqi: Sqaroj se pa komision ai nuk do kishte kaluar, do ti gjejë emrat kush kanë qenë dhe do i sjelli.

I falenderoj të gjithë për vëmendje dhe e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:00.

Procesmbajtës:

znj. Fitore Velijaj

Kryesues i Kuvendit:

z. Muharrem Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	
REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	2-155/4449
Një. Org	2
Nr. i faq.	1
Data	15.06.2021



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

Referencë/Reference:	Nr.V-06/2021
Për/To/Za :	z.Muharrem Krasniqi – Kryesues i Kuvendit të Junikut
Cc :	Asambleistët e Kuvendit të Junikut
PËRMES :	z. Agron Kuçi – Kryetar i komunës së Junikut
Nga/From/Od:	z. Leonard Llojuni - Drejtor për Ekonomi dhe Zhvillim
Date/Date/Datum:	15.06.2021
Tema/Subject/Subjekat:	Kërkesë për anulim të vendimit për falje të borgjeve




Të nderuar,

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në Komunën e Junikut, pas kërkesës drejtuar asamblesë Komunale të Junikut për falje të borgjeve për vitin 2021, të Bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Junikut që rrjedhin nga rregullorja Komunale për taksa dhe tarifa për ushtrim të veprimtarive, ka pranuar raport për ligjshmërinë e Vendimit ku në bazë të raportit të derguar nga Ministria e financave, Vendimi ynë për falje të borgjeve të bizneseve për vitin 2021 nuk është shpallur si i ligjshëm dhe kështu kërkojmë nga Kuvendi Komunal në Junik që ky vendim të anulohet.

Paraprkisht ju faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj !

Me respekt



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Agron Kuçi, Kryetar i Komunës së Junikut Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së	
Përmes:		
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 31/05/2021 Nr.020-417/2
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Leonora Bajrami, Zyrtare për monitorim të komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Junikut	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendim për faljen e borxheve për vitin 2021 për të gjitha bizneset te cilat paguajnë borxhet paraprake dhe po ashtu bizneset qe i kanë kryer obligimet e tyre te lirohen ne vitin 2022**, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Junikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Veçqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

<i>Vendim Nr. 02/11/2021 për faljen e borxheve për vitin 2021 për të gjitha bizneset të cilat paguajnë borxhet paraprake</i>
<i>Enratuar në datë 30.04.2021</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 11.05.2021</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 14.05.2021</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Junikut, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

- Në pajtim me nenin 2, paragrafin 3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal (këtej e tutje "Ligji"), kuvendi komunal dhe zyrtarët ekzekutiv kanë të drejtë që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga *te hyrat vetanake komunale*.

Për shkak të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se neni 8 i Ligjit në mënyrë taksative i evidenton kategoritë e të hyrave vetanake komunale. Andaj, përderisa komunat kanë diskrecion që të vendosin lirshëm, tjala vjen, taksat komunale – të njëjtit ruajnë diskrecionin që të falin borxhin e këtyre taksave, si proces i menaxhimit të burimeve financiare.

Mirëpo, në rastin konkret, për të vlerësuar ligjshmërinë e aktit komunal, Komuna e Junikut në vendimin i cili është subjekti i ligjshmërisë, ka dështuar ta specifikojë burimin financiar nga ku ka lindur, dhe rrjedhimisht nga ku po falen borxhi. Në mungesë të këtij specifikimi dhe/ose precizimi, Ministria e ka të pamundur të bëjë konstatimin nëse akti komunal është i ligjshëm ose jo.

Madre për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Junikut detaje dhe informata shtesë rreth burimit financiar të masës së përcaktuar me këtë akt komunal, në mënyrë që të procedohet tutje me shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Junikut dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë shkresë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarshtro Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve
Kopje:	Kryetar i Komunës së Junikut Njësia për Administrim e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Zyrtari përgjegës:	
1. Zyrtari përgjegës për përçelljen e aktit të Komunave në Ministri të Ligjeve	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari përgjegës për hartimin e aktit të Komunave	Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave
Lloji:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Junikut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar; Vendim për faljen e borxheve për vitin 2021 për të gjitha bizneset të cilat paguajnë borxhet paraprake dhe po ashtu bizneset që i kanë kryer obligimet e tyre të lirohen në vitin 2022. I nënshkruar nga Kryesuesi i kuvendit të komunës së Junikut, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim.

Vendim për faljen e borxheve për vitin 2021 për të gjitha bizneset të cilat paguajnë borxhet paraprake dhe po ashtu bizneset që i kanë kryer obligimet e tyre të lirohen në vitin 2022.

I miratuar më datë: 30.04.2021

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 11.05.2021



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E JUTOC - OPSTINA JUTOK - MUNICIPALITY OF JUTOK



Numërimi i vendit
N. 02/19/2022
D. 02: 07.05.2022

Kjo bazë ligjore është 12-punkto e paragraf 12.4 nën titullin 4.2.2. dhe është e përbërë nga: 1. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 3. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2.

VENDIM

Më 07.05.2022, në mbledhjen e Këshillit të Jutoc, për të marrë vendim për titullin 4.2.2. dhe 2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 3. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2.

Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 3. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2.

Kjo vendim është i bazuar në titullin 4.2.2. dhe 2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 3. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2.

Më 07.05.2022, në mbledhjen e Këshillit të Jutoc:

1. Mbledhja e Këshillit të Jutoc, për të marrë vendim për titullin 4.2.2. dhe 2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 3. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2.
2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 3. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2.
3. Mbledhja e Këshillit të Jutoc, për të marrë vendim për titullin 4.2.2. dhe 2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 3. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2.
4. Mbledhja e Këshillit të Jutoc, për të marrë vendim për titullin 4.2.2. dhe 2. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2. dhe 3. Karta e Jutoc Nr. 02/19/2022, datë 07.05.2022, për titullin 4.2.2.

07.05.2022
07.05.2022

07.05.2022
07.05.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministristvo Financija, Posla i Transfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers

PS: Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Trin Berisha, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: Kryetari i Komunës së Junikut

Ndërsa për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Për: Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ndë: Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit i punës dhe Transfereve

Zyrtari përgjegjës

Reference

Zyrtari hartues: Miroslava Bajgora, Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Objekt: Kërkesë për plotësim të dokumenteve dhe ose informacionit kërkuar

Shprehim: Vendim

Redaktuar: Ministër z. Krasniqi,

Redaktuar: Sekretar i Përgjithshëm z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për pushtet dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, Departamentit i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ku pranim për shqyrtim të detyrueshem



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	2-155/442
Një. Org	2
Nr. i faq.	1
Data	15/06/2021



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOŠOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Nr. I-180/17/21
DATE:	15.06.2021
PËR/ZA/TO:	z.Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z.Agron Kuçi - Kryetar i Komunës së Junikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë



Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), neni 42, pika j) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr. 001/3127, të datës: 29.9.2010), neni 16-i i rregullorës për Punën e Kuvendit të Komunës së Junikut dhe Rregullores për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medalket, Mirënjohjet dhe Falënderimet në Komunën e Junikut, ju bëjmë këtë:

KËRKESË

Që të vendosni në rendin e ditës në mbledhjen e radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal kërkesën për:

Ndarjen e çmimit „ Kuvendi i Junikut” për martirët dhe dëshmorëve të rënë për Liri, në mbrojtje të Junikut dhe Atdheut.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
UJ/No. PUN.	2-185/4432
No. Org.	2
No. i llog.	1
Data	15.06.2021



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	11.06.2021
PËR/ZA/TO:	Muharrem Krasniqi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Agron Kuçi - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Kosovare Gacaferi- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite shqyrtimin për instruksionin e rishikimit të Buxhetit për vitin 2021



Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP) nr:
03/L-048 neni 25 për ndryshimet e Buxhetit kërkojmë që të shtohet në rend dite
Rishikimi i Buxhetit për vitin 2021.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

(Projekt)

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
KOMUNALE**

2022- 2024

JUNIK, 2021

I. KORNIZA AFATMESME BUXHETORE PËR K.K – JUNIK

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) që po e paraqesim këtu është një dokument i cili miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake. Shpenzimet janë planifikuar ashtu që të pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuara në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Hartimi i KAB-it 2022-2024 është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Buxhetore 2022/01 për Komunat, lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve.

Ne kemi shqyrtuar KAB-in në kuptim të planifikimit afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Parashikimet ekonomike dhe buxhetore;
- Strategjinë zhvillimore komunale;
- Totalët e vlerësuar të të hyrave nga të gjitha burimet e financim;
- Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe ;
- Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave
- Paraqitja e prioritetëve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritetet dhe rezultatet e arritura.
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioritetëve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe caqeve për të matur progresin drejt prioritetëve strategjike dhe rezultateve

KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2022-2024.

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Junikut është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2022/2024 të dhëna nga MFT përmes qarkores buxhetore 2022/01 .

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB – Komunal do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Junikut

si dhe projektet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2022 – 2024, gjithnjë duke u bazuar në :

1. Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal
2. Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit
3. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe
4. Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal

II. OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Me kornizën afatmesme buxhetore 2022–2024 të Komunës së Junikut synohen të arrihen këto objektiva:

- ❖ Zhvilloj, promovoj dhe rigjeneroj infrastrukturën lokale;
- ❖ Përmirësoj ambientin për të jetuar;
- ❖ Përmirësoj sigurinë dhe shëndetin e komunitetit;
- ❖ Zhvilloj sferën e shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit;
- ❖ Ofroj mjete për nevojtarët dhe të dëmtuarit;
- ❖ Përkrah dhe zhvilloj biznesin dhe aftësitë individuale të talentëve etj.

III. Perspektiva e politikave fiskale

Korniza makroekonomike

Komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), prandaj Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2022-2024 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Parashikimi i të hyrave komunale

Të hyrat komunale të Komunës sonë realizohen në bazë të Rregullores mbi Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyra, siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Tabela 1. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale

	Burimet e te hyrave	2021 Buxheti	2022	2023	2024
			Projeksioni		
1	Gjithsej grantet ndërqeveritare	1,423,901	1,499,553	1,564,609	1,635,410
2	Gjithsej te hyrat vetanake te komunës	122,802	159,038	168,880	176,660
2.1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	8,449	11,481	11,575	11,730
2.2	Te hyrat nga urbanizmi	14,000	19,100	19,100	20,100
2.3	Te hyrat nga administrata	6,900	7,100	7,200	7,300
2.4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	6,000	10,000	10,300	10,600
2.5	Te hyrat nga tatimi ne pronë	57,853	92,557	100,405	106,130
2.6	Të hyrat nga tatimi ne tokë	11,700			
2.7	Regjistrimi i Automjeteve	5,900	6,000	6,200	6,300
2.8	Te hyrat nga shëndetësia	6,000	6,200	6,900	7,000
2.9	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,000	4,100	4,200	4,300
2.10	Të hyrat tjera	2,000	2,500	3,000	3,200
	TOTALI	1,546,703	1,658,591	1,733,489	1,812,070

Tabela 2. Vlerësimet e hershme të buxhetit 2022

Emri i Drejtorisë/Programit '000 euro	Viti buxhetor (2021)					Vlerësimi i hershëm Viti 1 (2022)					Vlerësimi i hershëm Viti 2 (2023)					Vlerësimi i hershëm Viti 3 (2024)				
	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali	P&M	M&Sh	Shpenz.komunale	Subvencione	Kapitali
Zyra e Kryetarit	78.4	6.7	0.2	30.5		78.7	6.7	0.2	50		79.0	6.7	0.2	50		79.4	6.7	0.2	50	
K. Komunal	61.6	4.0				60.2	4.0				60.3	4.0				60.3	4.0			
D. per planifikim urban, Gjeodezi dhe kadaster	49.0	9.9			20	48.7	9.9			20	48.9	9.9			20	49.1	9.9			49
D. per Administratë të përgjithshme	84.5	34.3	6.7		80	85.7	43.8	6.7		31.5	86.0	43.8	6.7		38	86.4	43.8	6.7		38
D. Buxhet dhe Financave	64.0	7.9	0.1			64.6	7.0	0.1			64.6	7.0	0.1			64.9	7.0	0.1		
D. Ekon. Bujqësi, pylltari dhe turizem	53.1	9.0	0.4		29.3	53.3	10.1	0.4		144.5	53.5	10.1	0.4		176	53.8	10.1	0.4		176
D. Shërbimeve Publike	61.9	30.0	13.3		20	63.1	30.5	13.3		20	62.4	33.9	13.8		20	62.7	38.5	13.9		20
D. e Arsimit	35.5	4.8				35.5	4.7				35.7	4.7				35.9	4.7			
D. e Shëndetësisë	15.6	4.2				15.5	4.2				15.6	4.2				15.7	4.2			
ZKIS	6.6					6.7					6.8					6.8				
TOTALI:	510.2	110.7	20.6	30.5	149	512	120.7	20.6	50	216	512.86	124	21.2	50	254	514.82	129	21.2	50	282
Arsimi fillor	280.8	23.9	4.9		10	282.9	32.8	4.9		10	283.4	32.8	4.9		30	284.5	32.8	4.9		55
Arsimi I mesëm	119.2	10.7	3.6			125.5	10.7	3.6			125.9	10.7	3.6			126.4	10.7	3.6		
QKMF	227.1	24.1	5.7			224.4	24.1	5.7			225.3	24.1	5.7		10	226.2	24.6	5.8		25
Mirqenia Sociale	10.5	3.5	1.4			10.5	3.5	1.4			10.6	3.5	1.4			10.6	3.5	1.4		
SUB TOTALI	1147.8	172.9	36.2	30.5	159	1155	191.8	36.2	50	226	1158.0	195	36.8	50	294	1162.6	200	36.9	50	362

SPECIFIKACION

BUXHETI KOMUNAL JUNIK	VITI 2021 (000 EURO)	VITI 2022 (000 EURO)	VITI 2023 (000 EURO)	VITI 2024 (000 EURO)
	1,547	1,659	1,733	1,812

IV. Vlerësimet e hershme të programeve buxhetore

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pas për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2021.

Kjo kornizë paraqet parashikimin 3 vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend rritës për vitin 2022 gjithashtu edhe për dy vitet tjera pasuese me një trend të rritjes për çdo vjet.

Grandet qeveritare kanë rritje për vitin 2022 gjithashtu me një trend të rritjes në vitet pasuese të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i grandeve të MFT.

Projeksionet e shpenzimeve të buxhetit komunal

Më datën 14.05.2021 kanë arritur Limitet e para buxhetore për komunat për periudhën 2022/2024. Granti fillestar i Qeverisë për Komunën e Junikut është si vijon:

Tabela nr. 3 Limitet fillestare sipas qarkores buxhetore 2022/01

Limiti fillestar	Granti i Arsimit	Granti i Shëndetësisë	Granti i Përgjithshëm	Gjithsej granti Komunal
2022-Kufijtë e financimit	465,747	244,547	789,259	1,499,553
2023-Parashikimet	489,035	256,774	818,800	1,564,609
2024-Parashikimet	513,487	269,613	852,310	1,635,410

Tabela nr.4. Projektioni i të hyrave Buxhetore nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake 2022/2024 të Komunës së Junikut

K. K. Junik	Buxheti - 2022	Buxheti – 2023	Buxheti – 2024
Të hyrat nga granti qeveritar	1,499,553	1,564,609	1,635,410
Të hyrat vetanake	159,038	168,880	176,660
TOTALI	1,658,591	1,733,489	1,812,070

Tabela nr. 5. Korniza afatmesme buxhetore 2022/2024 sipas kufijve fillestar

K. K. Junik	Buxheti - 2022	Buxheti - 2023	Buxheti – 2024
Paga dhe mëditje	1,154,611	1,158,039	1,162,590
Mallra dhe shërbime	191,780	195,180	200,310
Shpenzime komunale	36,200	36,770	36,870
Subvencione	50,000	50,000	50,000
Investime kapitale	226,000	293,500	362,300
TOTALI	1,658,591	1,733,489	1,812,070
Burimet e financimit			
Granti i Qeverisë	1,499,553	1,564,609	1,635,410
Të hyrat vetanake	159,038	168,880	176,660
TOTALI	1,658,591	1,733,489	1,812,070

Në tabelën vijuese pas pranimit të limiteve finale do të paraqesim shpërndarjen e buxhetit final sipas programeve për vitet 2022/2024

Strategjia e shpenzimeve sipas Drejtorive/Programeve dhe deklarata e misionit dhe qëllimeve

ZYRA E KRYETARIT

Kryetari: Agron Kuçi

Deklarata e misionit: Kryetari i komunës, përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj, udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij; ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës; emëron dhe shkarkon zëvendësit dhe drejtorët e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative e investuese, propozon Buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko - financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës; si dhe ndërmerr aktivitetet e tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo akte të tjera ligjore dhe nën ligjore të cilat janë në fuqi.

Përgatitë të gjitha materialet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve etj. gjithnjë me qëllim të arritjes të një qeverisje sa më të mirë, koordinon punën me të gjitha drejtoritë etj. Ofron çasje në dokumente zyrtare në mënyrë të arritjes së një transparence sa më të madhe në punë, etj.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi primar është që të gjitha kompetencat e Komunës të rregulluara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës të zbatohen në përpikëri në mënyrë që misioni i Komunës të shënoj shkallën sa më të lartë të performancës duke i realizuar me sukses qëllimet strategjike komunale.

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	78,662.76	79,020.63	79,378.51
2	Mallra dhe shërbime	6,650.00	6,650.00	6,650.00
3	Komunalit	150.00	150.00	150.00
5	Subvencione	50,000.00	50,000.00	50,000.00
6	Kapitalet	-	-	-
TOTALI		135,462.76	135,820.63	136,178.51
Numri i te Punësuarve		8	8	8

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL

Kryesuesi: Muharrem Krasniqi

Deklarata e misionit: Kuvendi i Komunës është organi më i lartë legjislativ i Komunës, i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Kuvendi i Komunës mund të miratoi aktet dhe të ndërmer masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre e që vlejnë brenda territorit të Komunës dhe në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, dhe atë: statutin e Komunës; rregulloren e punës; rregulloret komunale; dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin e komunës.

Deklarata e qëllimit: Zhvillimi lokal ekonomik, planifikimi urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, afirmimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; ofrimin e për kujdesit publik shëndetësor, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale; turizmin, aktivitetet kulturore dhe të lira, çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre apo që nuk është përcaktuar ndonjë autoritet tjetër.

Kategoria buxhetore	2022	2023	2024
1 Paga dhe mëditje	60,248.91	60,289.45	60,329.99
2 Mallra dhe shërbime	4,000.00	4,000.00	4,000.00
3 Komunalit	-	-	-
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	-	-	-
TOTALI	64,248.91	64,289.45	64,329.99
Numri i te Punësuarve	15	15	15

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**Drejtori: Leonita Jasiqi**

Deklarata e Vizionit: Ofrimi i shërbimeve efikase dhe të cilësisë së lartë, që u përgjigjen qytetarëve dhe i përmbushin nevojat e tyre.

Deklarata e Misionit: Udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet administrative – teknike të drejtorisë dhe ato të Shërbimit Civil Komunal që bien në këtë kompetencë. Udhëheqë me librat amë, të gjendjes civile, lëshon certifikata të gjendjes civile, sjellë aktvendime për regjistrime të mëvonshme, përmirësime dhe ndryshime të emrit e mbiemrit personal, harton aktet normative që bien në kompetencë të drejtorisë, udhëheq punën e arkivit komunal, zyrën e pritjes, sektorin teknik dhe të mirëmbajtjes, logjistikës, angazhohet dhe përcjellë punën e bashkëpunimit me vendbanimet dhe fshatrat. Gjithashtu kryen edhe punë të tjera që janë kompetencë e drejtorisë e që janë të bazuara në ligje, statut të Komunës, rregullore dhe udhëzime administrative, të cilat janë në fuqi.

Deklarata e Qëllimit: Koordinimi i punës me Drejtoritë Komunale në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Junikut. Pranimi i lëndëve nga palët dhe procedimi i tyre në zyrat e administratës Komunale, dhënia e informatave për palët lidhur me kërkesat dhe ankesat e tyre. Pajisja e palëve me kohë dhe në mënyrë transparente me dokumentacion personal nga librat e amzës. Përgatitja dhe plasimi me kolle në ueb-faqe të informatave për ecuritë, të arriturat dhe punën në Administratën Komunale si dhe shërbime të tjera që janë në kompetencë të drejtorisë në fjalë.

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	85,659.02	86,014.61	86,370.19
2	Mallra dhe shërbime	43,750.00	43,750.00	43,750.00
3	Komunalit	6,700.00	6,700.00	6,700.00
5	Subvencione			
6	Kapitalet	31,500.00	37,500.00	37,500.00
	TOTALI	167,609.02	173,964.61	174,320.19
	Numri i te Punësuarve	14	14	14

Të hyrat vetanake		2022	2023	2024
1.	Te hyrat nga Administrata (Gjendja Civile LAL, LAM etj)	7,100	7,200	7,300
2.				
3.				
	TOTALI:	7,100	7,200	7,300

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA**Drejtori: Kosovare Gacaferi**

Deklarata e Vizionit: Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të jetë çdo herë e saktë në planifikime, e besueshme dhe transparente.

Deklarata e Misionit: Menaxhon dhe operon me mjetet buxhetore të Komunës, i siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon lidhur me aktualitetet e ndërlidhura me Buxhetin e Komunës. Përgatit raportet për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvend lidhur me menaxhimin e financave komunale, përgatitjen dhe prezantimin e Buxhetit, koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin. Gjithashtu, në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa hyn edhe Zyra e Tatimit në pronë, e cila ka si mision inkasimin e të hyrave nga tatimi në pronë, që dedikohen për projekte kapitale, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Deklarata e Qëllimeve: a) Planifikimi i saktë dhe efikas i Buxhetit
 b) Shpenzimi i Buxhetit në mënyrë racionale dhe në përputhje me ligjet në fuqi
 c) Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake komunale

Kategoritë buxhetore	2022	2023	2024
1 Paga dhe mëditje	64,559.50	64,588.59	64,869.69
2 Mallra dhe shërbime	7,000.00	7,000.00	7,000.00
3 Komunalit	100.00	100.00	100.00
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	-	-	-
TOTALI	71,659.50	71,688.59	71,969.69
Numri i te Punësuarve	9	9	9

Të hyrat vetanake	2022	2023	2024
1. Te hyrat nga Tatimi ne pronë dhe ne tokë	92,557	100,405	106,130
2. Te hyrat nga regjistrimi i automjeteve	6,000	6,200	6,300
3. Te hyrat tjera	2,500	3,000	3,200
TOTALI:	101,057	109,605	115,630

Deklarata e misionit: Misioni i përgjithshëm i DSHP-së është realizimi i suksesshëm i Planit për Parandalimin e Emergjencave, reagimin e shpejtë dhe të suksesshëm ndaj emergjencave, intervenime të suksesshme të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, rritjen e performansës në Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit, rritjen e performansës në transportin publik të udhëtarëve, ndriçimin elektrik të qytetit si dhe rritjen e performansës në ndërmarrjet publike për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave.

Deklarata e qëllimit: Qëllimi i drejtorisë do të jetë ndërtimi dhe riparimi i rrugëve të qytetit dhe atyre lokale, ndërtimi i rrjeteve të reja të ujësjellësit, ndërtimi i rrjeteve të reja të kanalizimit të ujërave të zeza, ndërtimi i parqeve, shesheve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara, ndërtimi i rrjeteve të reja të ndriçimit publik.

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	63,060.05	62,421.79	62,665.53
2	Mallra dhe shërbime	30,500.00	33,900.00	38,500.00
3	Komunalit	13,820.00	13,820.00	13,350.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	20,000.00	20,000.00	20,000.00
TOTALI		127,380.05	130,141.79	135,015.53
Numri i te Punësuarve		9	9	9

Të hyrat vetanake		2022	2023	2024
1.	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,100	4,200	4,300
2.				
3.				
TOTALI:		4,100	4,200	4,300

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK**Drejtori: Leonard Ljolluni**

Deklarata e misionit: Krijimi i infrastrukturës moderne, ngritja e standardit jetësor, zhvillim më të shpejt gjithnjë duke ruajtur ambientin dhe krijimi i mundësive për zhvillim të turizmit si pika kyqe e Komunës për zhvillim më të madh ekonomik.

Deklarata e qëllimit: Menaxhimi, koordinimi i punës me Drejtoritë e Qeverise Komunale në krijimin, implementimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal (Planit për zhvillim strategjik). Koordinimi i aktiviteteve për Zhvillim Ekonomik me subjektet ekonomike (NVM) për mundësinë e investimeve, angazhimit të kapitalit të tyre në veprimtaritë prodhuese dhe profitabile, por edhe perspektive. Përgatitja e projekt propozimeve, duke marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe nxitja e komunitetit për bashkëfinancim, si dhe Menaxhimin dhe koordinimin në fushën e Bujqësisë, Turizmit dhe të Pylltarisë.

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	53,306.76	53,540.19	53,752.66
2	Mallra dhe shërbime	10,080.00	10,080.00	10,080.00
3	Komunalit	400.00	400.00	400.00
5	Subvencione			
6	Kapitalet	144,500.00	176,000.00	176,000.00
TOTALI		208,286.76	240,020.19	240,232.66
Numri i te Punësuarve		10	10	10

Të hyrat vetanake		2022	2023	2024
1.	Te hyrat nga ushtrimi i veprimtarive te bizneseve	10,000	10,300	10,600
2.				
3.				
TOTALI:		10,000	10,300	10,600

Deklarata e misionit: Kjo drejtori është përgjegjëse për:

a) Hartimin e planit zhvillimor të komunës, b) Hartimin e planit të zhvillimit hapësinor, urbanistik dhe rural të komunës, c) Harton kriteret për dhënien e lejeve të ndërtimit, d) Harton kriteret për dhënien me qira të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të komunës, e) Mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda territorit të komunës, f) Bënë vlerësimin e pronës sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi. g) Mban regjistrin e pronës së paluajtshme dhe regjistrin e tokës komunale, h) Bënë azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara. i) Harton rregullore lokale për kontrollimin e mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të komunës, j) Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit, k) Punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligj.

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	48,675.89	48,894.22	49,112.55
2	Mallra dhe shërbime	9,900.00	9,900.00	9,900.00
3	Komunalit			
5	Subvencione			
6	Kapitalet	20,000.00	20,000.00	48,800.00
	TOTALI	78,575.89	78,794.22	107,812.55
	Numri i te Punësuarve	7	7	7

Të hyrat vetanake		2022	2023	2024
1.	Te hyrat nga Urbanizmi (lejet e ndërtimit)	19,100	19,100	20,100
2.	Te hyrat nga shërbimet kadastrale	11,481	11,575	11,730
3.				
	TOTALI:	30,581	30,675	31,830

Deklarata e misionit: Udhëheqë dhe menaxhon me të gjitha çështjet arsimore – administrative- teknike të Drejtorisë dhe shkollave. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës është përgjegjëse për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e arsimit në nivel komunal.

Planifikon udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në Drejtori, pjesëmarrjen në procesin e zgjedhjes dhe emërimit të personelit dhe Drejtorit në shkollë; bën mbledhjen dhe analizën e informatave për të gjitha çështjet e sistemit në komunë; bën sigurimin e hapësirës së nevojshme shkollore për përfshirjen e të gjithë fëmijëve dhe të rriturve në shkollim; aftësimin e personelit të Drejtorisë; transparencën dhe depolitizimin e arsimit; planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit për arsimin komunal; komunikimin me prind dhe publikun për çështje që kanë të bëjnë me procesin arsimor në komunë; dhe punë tjera në fushën e arsimit që obligohet nga komuna dhe MASHT-i.

Menaxhon, udhëheqë dhe kryen të gjitha punët përkitazi me lëmin e kulturës në Komunë, organizon punën dhe aktivitetet me rininë në të gjitha fushat, organizon jetën sportive dhe siguron kushte për zhvillimin e sportit.

Administrata, Drejtoria e Arsimit

Kategoritë buxhetore	2022	2023	2024
1 Paga dhe mëditje	35,557.63	35,714.93	35,872.24
2 Mallra dhe shërbime	4,650.00	4,650.00	4,650.00
3 Komunalit			
5 Subvencione			
6 Kapitalet			
TOTALI	40,207.63	40,364.93	40,522.24
Numri i te Punësuarve	5	5	5

Shkolla fillore “ EDMOND HOXHA”

Kategoritë buxhetore	2022	2023	2024
1 Paga dhe mëditje	282,232.55	283,363.49	284,474.52
2 Mallra dhe shërbime	32,750.00	32,750.00	32,750.00
3 Komunalit	4,900.00	4,900.00	4,900.00
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	10,000.00	30,000.00	55,000.00
TOTALI	329,882.55	351,013.49	377,124.52
Numri i te Punësuarve	45	45	45

Shkolla e mesme “ KUVENDI I JUNIKUT”

Kategoritë buxhetore	2022	2023	2024
1 Paga dhe mëditje	125,466.69	125,934.03	126,430.07
2 Mallra dhe shërbime	10,700.00	10,700.00	10,700.00
3 Komunalit	3,600.00	3,600.00	3,600.00
5 Subvencione	-	-	-
6 Kapitalet	-	-	-
TOTALI	139,766.69	140,234.03	140,730.07
Numri i te Punësuarve	18	18	18

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**Drejtori: Zenel Kuçi**

Deklarata e misionit: Misioni i DSHMS-së është zhvillimi dhe sigurimi i shërbimeve efektive për plotësimin e nevojave të popullsisë së Komunës. Sigurimi i kornizës menaxhuese për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme në nivelin primar shëndetësor, përmirësimi i vazhdueshëm kualitativ të shërbimeve shëndetësore.

Deklarata e qëllimit: Përmirësimi i duhur i shëndetit të qytetarëve, parandalimi i sëmundjeve ngjitëse, imunizimi dhe vaksinimi, ofrimi i shërbimeve sa më cilësore dhe efikase në kujdesin primar shëndetësor.

Administrata, Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	15,544.73	15,614.43	15,684.13
2	Mallra dhe shërbime	4,200.00	4,200.00	4,200.00
3	Komunalit			
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	-	-
TOTALI		19,744.73	19,814.43	19,884.13
Numri i te Punësuarve		2	2	2

QKMF

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	224,371.85	225,301.86	226,233.00
2	Mallra dhe shërbime	24,100.00	24,100.00	24,630.00
3	Komunalit	5,680.00	5,680.00	5,750.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	10,000.00	25,000.00
TOTALI		254,151.85	265,081.86	281,613.00
Numri I te Punësuarve		33	33	33

Të hyrat vetanake		2022	2023	2024
1.	Te hyrat nga Shëndetësia	6,200	6,900	7,000
2.				
3.				
TOTALI:		6,200	6,900	7,000

Shërbimet sociale

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	537.85	10,583.53	10,629.20
2	Mallra dhe shërbime	3,500.00	3,500.00	3,500.00
3	Komunalit	1,420.00	1,420.00	1,420.00
5	Subvencione	-	-	-
6	Kapitalet	-	-	-
TOTALI		5,457.85	15,503.53	15,549.20
Numri I te Punësuarve		2	2	2

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE**Udhëheqës:**

Deklarata e misionit: Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryetarit, ndihmon në përpilimin e strategjisë së kthimit në nivel komunal. Harton informata lidhur me kthimet dhe ri integrimet në Komunë.

Kategoritë buxhetore		2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	6,726.81	6,757.26	6,787.71
2	Mallra dhe shërbime			
3	Komunalit			
5	Subvencione			
6	Kapitalet			
	TOTALI	6,726.81	6,757.26	6,787.71
	Numri i te Punësuarve	1	1	1

Programi komunal i investimeve publike (PIP)

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim Listën e projekteve kapitale të parapara me Buxhetin e vitit 2021, me financim nga të hyrat e fondit të ndarë për Komunën e Junikut, si dhe Listën e projekteve për vitet 2022/2024 të parapara me financim nga të hyrat vetanake dhe nga donatorët. Kjo listë mund të modifikohet me propozime të reja që do të vinë nga Drejtoritë gjatë shqyrtimit me Drejtorët e Drejtorive, palët e interesit, strukturat tjera udhëheqëse dhe organeve relevante komunale për hartimin e politikave zhvillimore të Komunës duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për financim si dhe aftësitë dhe burimeve të ardhurave komunale, si dhe Grandet e Qeverisë, Participimet e qytetarëve dhe Donatorët e ndryshëm.

Nr.	Përshkrimi i projektit	Drejtoria	Burimi i financimit	Shuma totale e financimit	Financimi sipas viteve ('000 euro)			
					2021	2022	2023	2024
					Buxheti			
1	Bashkëfinancim i projekteve	DZHE	KK. Junik	338.305	9.305	106	110	113
2	Rehabilitimi i rrugëve lokale	DSHPMI	KK. Junik	80	20	20	20	20
3	Ndërtimi i kornaleve të ujërës	DZHE	KK. Junik	110	20	50	20	20
4	Asfaltimi i rrugëve lokale në lagjet e Junikut	DUKM	KK. Junik	70	20	20	30	
5	Hapja e rrugëve fushore	DZHE	KK. Junik	70	20	20	20	10
6	Rregullimi i hapësirave sportive, rekreative, dhe të ambientit në shkollën fillore "Edmond Hoxha"	DAKRS	KK. Junik	130		10	60	60
7	Ndërtimi i rrjetit sekondar të kanalizimit për ujëra të zeza	DSHPMI	KK. Junik	11	11			
8	Furnizimi me shporta dhe kontejner për mbeturina	DSHPMI	KK. Junik	10	5		5	
9	Blerja e automjetit për nevojat e komunës	DAP	KK. Junik	30			30	
10	Furnizim me gjenerator për objektin e Administratës	DAP	KK. Junik	10	10			
11	Hartimi i hartave zonale	DUKM	KK. Junik	30	25	5		
12	Ndërtimi i parqeve dhe këndeve të lojërave për Fëmijë	DUKM		50			20	30
13	Ndërtimi i Objektit social për banim	DSHMS		218.5			105	113.5
14	Ndërtimi i rrjetit elektrik Gjocaj -Gjeravic	DSHPMI		250			150	100
15	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Lagjen Agim Ramadani	DSHPMI		100		100		
16	Hapja, Gjurmimi dhe Vënia në funksion e vendbanimit të periudhës së bronzit për vizitorët "Gropa e Amonit"	DZHE		390			390	
17	Restaurimi dhe vënia në funksion e monumenteve të vjetra si: Kullat, Mullinjtë dhe Valavicat	DZHE		300			300	
18	Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve të reja për ecje qarku Moronice Zharre	DZHE		30			30	
19	Rekonstruimi i rrugës "Junik - Rastovic"	DUKM		450		200	250	

20	Asfaltimi i rrugëve lokale Junik - Jasiq	DUKM		100		50	50	
21	Ndërtimi i linjës Via-Ferrata në Lokacionin "Shkëmbi i Jedovës"	DZHE		10		10		
22	Ndërtimi i objektit të Shkollës Fillore	DAKRS		650		650		
23	Ndërtimi i stadiumit të futbollit	DAKRS		150			150	
24	Furnizimi me pajisje sportive për dy shkollat	DAKRS		15			15	
25	Ndërtimi i ujëmbledhësve në Komunën e Junikut	DUKM		2,500			2,000	500
26	Hartimi i projektit për ndërtimin e ujëmbledhësit dhe rrjetit të ujitjes në Junik	DUKM		25		10	15	
27	Ndërtimi i Ashensorit në QKMF	DSHMS		25			25	
28	Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Erenik Segmenti Berishe -Nivokaz	DUKM		20		10	10	
29	Ndërtimi i rrjetit elektrik eficient lokal	DSHPM I		70			70	
30	Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të lumit Erenik Segmenti Tofaj – Qafa e Jasiqit	DUKM		10		5	5	
31	Zërimi i asamblesë komunale	DAP		26		26		
32	Hapja e shtegrit malorë për Biciklistë	DZHE		15		5	5	5
33	Hapja dhe trasimi i rrugëve malore	DZHE		210		100	60	50
34	Ndërtimi i tranzitit Botush-Nivokaz-Dobresht-Pacaj- Hereq	DUKM		250			100	150
35	Ndërtimi i palestrës sportive në Junik	DAKRS		700		350	350	
36	Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura	DZHE		120	40	40	40	
37	Ndërtimi i shtratit të lumit Erenik segmenti Tofaj – qafa e Jasiqit	DUKM		500			250	250
38	Ruajtja, Sanimi dhe Rregullimi i burimeve të ujit të pijes në Ekofshatrat-Bjeshke	DZHE		30		30		
39	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave rekreative dhe sportive përgjatë lumit Erenik	DSHPM I		200			200	
40	Ndërtimi i zonës ekonomike për investitorë të huaj	DZHE		300			150	150
41	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve të asfaltuara lokale	DSHPM I		5		5		
42	Ndërtimi i trotuarit në rrugën Gaxherr-Bajraktar - Pepsh	DUKM		50			50	
43	Rregullimi i Sheshit në Qendër të qytetit	DUKM		500			250	250
44	Ndërtimi i palestrës sportive në Gjimnazin "Kuvendi i Junikut"	DAKRS		500			250	250
45	Ndërtimi i qerdhës për fëmijë	DAKRS		200			50	150
46	Rregullimi i oborrit në Shkollën fillore "Edmond Hoxha"	DAKRS		65			65	
47	Infrastruktura rrugore për persona me mobilitet të zvogëluar	DSHPMI		5			5	
48	Ndërtimi i kompleksit të dëshmorëve	DUKM		100			50	50
49	Ndërtimi i pendës së ujitjes në Qafë të Jasiqit- Tofaj- Pepsh	DZHE		50		50		
50	Ndërtimi i pishinave verore	DZHE		200			100	100
51	Ndërtimi i ujëmbledhësit në Traven e vogël	DUKM		500			250	250
52	Rregullimi i shtratit të lumit Erenik segmenti Berishe- Nivokaz	DUKM		1,000			500	500

53	Rekonstruimi i urës së Gurit	DUKM	25	25		
54	Zgjerimi i rrugës "Qendër-Shkollë Fillore- Pepsh- Teqja Halvetije Xhaferije"	DUKM	350		150	200
55	Ndërtimi i pallatit të kulturës	DAKRS	1,500			1,500
56	Asfaltimi i rrugës së Turbise	DUKM	200		100	100
57	Ndërtimi i qendrës kulturore-historike- tradicionale-Junikase	DAKRS	130	70	60	
58	Kohezimi i rrugëve	DSHPMI	13		13	
59	Rregullimi i shëtitores përgjatë lumit Trava	DUKM	100	50	50	
60	Ndërtimi i kabinetit të shkencave natyrore	DAKRS	10		10	
61	Ndërtimi i rrethojave të varrezave	DSHPMI	100		50	50
62	Gjelbërimi i hyrjeve të qytetit të Junikut me drunjtë dekorativ	DSHPMI	10	2	2	6
63	Rregullimi i hapësirave tek parku Moronica	DUKM	55		55	
64	Shëndrimi i hapësirave përgjatë lumit Erenik në zona rekreative	DSHPMI	20	10	5	5
65	Hapja dhe shënjëzimi i shtigjeve të ecjes për tek Kanioni i Erenikut	DZHE	20	5	5	10
66	Ndriçimi i hapësirave publike, parqeve	DSHPMI	10	5	5	
67	Funksionalizimi i parqeve, vendosja e ulësve, shportave për mbeturina	DSHPMI	10		5	5
68	Vendosja e kabinave pritëse në stacione nëpër lagje	DSHPMI	10		5	5
69	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi i rrugës Qendër-Lagja Agim Ramadani	DUKM	150		100	50
70	Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve në parkun Moronica	DZHE	30		10	20
71	Rregullimi i sheshit Qendër deri te shkolla fillore	DUKM	100	50	50	
72	Ndërtimi i Depos së Komunës	DAP	3.5	3.5		
73	Renovimi i objektit të komunës	DAP	20		20	
74	Ndërtimi i parkingut nëntokësor	DAP	350		350	
75	Ndërtimi i parkingut në lagjen Bajraktar	DAP	50		50	
76	Ndërtimi i shtegut në brendi të Kanionit të Junikut me material metalik dhe druri	DZHE	15	15		
77	Ndërtimi i pikave vrojtuese panoramike në Bjeshkët e Junikut	DZHE	9	5	2	2
78	Pastrimi i shtegut për lëshim me Bicikleta "Livadhi i madh – Gryka e Jasiqit"	DZHE	5	5		
79	Hapja dhe Rregullimi i shtegut për lëshim me Bicikleta "Livadhi i Bahqit-Livadhi i Verrave"	DZHE	10		10	

P. S. Vlerat e prezantuar në tabelë janë të shprehura në mijë (000) euro.

Kryetari i Komunës
Agron Kuçi

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa
Kosovare Gacaferi